



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11.07.2024

Nr: 79

Ora: 12:00

VENDIM
PËR

**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT
DHE SEKRETARIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT
ZGJEDHOR NR. 88, PËR ZGJEDHJET E PJESSHMEPËR KRYETAR TË
BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 244, datë 05.07.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 29, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pas përfundimit të shortit për anëtarin e shtatë të KZAZ-së, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

- Partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 88, që do të ngrihet dhe funksionojë për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, janë si më poshtë:
 - Tre anëtarë propozohen nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” (PSSH);
 - Dy anëtarë propozohen nga “Partia Demokratike” (PDSH);
 - Një anëtar propozohet nga “Partia e Lirisë” (PL).
- Anëtari i shtatë i KZAZ-së nr. 88 do të propozohet nga “Partia Demokratike” (PDSH).
- Sekretari i KZAZ-së nr. 88 do të propozohet nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” (PSSH).
- Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë dhe sekretar të KZAZ-së në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 11.07.2024 Nr: 79
Ora: 12:00



“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e komisionit të zonës së administrimit zgjedhor nr. 88 për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”